

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

KA.nr.181/11

Data: 9 nëntor 2011

Gjyqtarja konfirmuese i EULEX-it, gjyqtarja për lëndë penale Mariola Pasnik, duke vepruar në veprën penale kundër:

I.

Emri:	Besim
Mbiemri:	Tahiri
Pseudonimi:	"Qeqen "
Emri i babait:	Nijazi
Mbiemri i babait:	Tahiri
Emri i nënës:	Emine
Mbiemri i vajzërisë:	Azemi
Vendi i lindjes:	Vranje, Serbi
Vendbanimi:	Fshati Dobërçan, komuna e Gjilanit
Data e lindjes:	18/08/1980
Numri i letërnjoftimit:	n/k
Kombësia:	Shqiptar i Kosovës
Shtetësia:	Republika e Kosovës
Profesioni:	Sportist
Gjendja familjare:	I pamartuar
Di shkrim-lexim:	Po
Arsimimi:	n/k
Të ardhurat personale:	n/k
Gjendja ekonomike:	Mesatare
Procedurat penale në pritje:	Gjykim në pritje në GJQ të Gjilanit
Statusi i paraburgimit:	Në paraburgim që nga 24 shtatori 2011

II.

Emri:	Nijazi
Mbiemri:	Tahiri
Pseudonimi:	n/k
Emri i babait:	Sabri
Mbiemri i babait:	Tahiri
Emri i nënës:	Ajete
Mbiemri i vajzërisë:	Sherifi
Vendi i lindjes:	Suharne, komuna e Bujanocit, Serbi
Vendbanimi:	Fshati Dobërçan, komuna e Gjilanit
Data e lindjes:	19/01/1960
Numri i letërnjoftimit:	n/k
Kombësia:	Shqiptar i Kosovës

Shtetësia:	Republika e Kosovës
Profesioni:	Bujk. për momentin i papunësuar
Gjendja familjare:	I martuar
Di shkrim-lexim:	Po
Arsimimi:	Shkollimi fillor
Të ardhurat personale:	n/k
Gjendja ekonomike:	Mesatare
Procedurat penale në pritje:	n/k
Statusi i paraburgimit:	Ka qenë në paraburgim që nga 29/04/2011 deri më 29/07/2011, pastaj në masa ndaluese deri më 24/10/11

Të akuzuar me aktakuzën PPS Nr. 41/11 të paraqitur me 20 tetor 2011 nga Prokurori Publik Special, për veprën penale të detyrimit në shkelje të nenit 267 par. 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

Sepse

Të pandehurit Besim Tahiri dhe Nijazi Tahiri së bashku me 29 prill 2011, në Gjilan me qëllim të përfitimit të paligjshëm material për veten apo njëri-tjetrin kanë përdorur kërcënim serioz për të detyruar vëllezërit Qani and Shemsi Xhelili për të kryer një veprim në dëm të pasurisë së tyre. Besim Tahiri iu afrua Shemsi Xhelilit në vend parkimin afër bankës BKT në Gjilan, dhe i kërkoi Shemsi Xhelilit që ti jap atij 20.000 Euro apo përndryshe Shemsi Xhelili mund të harrojë Kosovën, familjen e tij dhe punën. Në të njëjtën ditë Nijazi Tahiri shkoi në zyrën e Qani dhe Shemsi Xhelilit në Gjilan dhe i kërkoi Qani Xhelilit që t'ia jap 20.000 Euro për Besim Tahirin apo përndryshe do të bëhet keq për Qani Xhelilin dhe familjen e tij. Me veprimin e tyre të pandehurit patën për qëllim të përfitojnë përfitim të madh material.

duke vepruar kështu, ata kanë kryer veprën penale të detyrimit në bashkë-veprim në shkelje të nenit 267 par. 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhje me nenin 23 të CCK.

Pas seancës për konfirmim të aktakuzës të mbajtur me 9 nëntor 2011, në prani të të pandehurve Besim Tahirin dhe avokatit të tij mbrojtës Haxhi Millakut, Nijazi Tahirin dhe avokatit të tij mbrojtës Masar Morina, dhe Prokurorit Publik Special, Olivier Beauvallet

Sipas nenit 316, par. 4 i KPPK-së,

Lëshon të mëposhtmin:

AKTVENDIM

1. **KONFIRMOHET** aktakuza PPS. Nr. 41/11, e datës 20 tetor 2011, e paraqitur kundër të pandehurve Besim Tahirit dhe Nijazi Tahirit, të akuzuar për veprën penale të detyrimit , të kryer në bashkëveprim në shkelje të nenit 267, par. 1 dhe 2 në lidhje me nenin 23 të KPK-së.
2. Të gjitha dëshmitë e përmendura në aktakuzë janë të pranueshme. Të gjitha dëshmitë që janë në dosjen e Gjykatës apo të cilave iu referohet në dokumente të paraqitura në gjykatë janë të pranueshme.
3. Pasi që aktakuza të bëhet e formës së prerë, aktakuza dhe shënimet e lëndës do të dërgohen menjëherë tek kryetari i trupit gjykues i kësaj gjykate për seancën kryesore.

ARSYETIM

1. Konstatimet e seancës për konfirmim të aktakuzës dhe pranueshmëria e dëshmive

Me 20 tetor 2011 Prokurori Special i PSRK-së, paraqiti aktakuzën PPS Nr. 41/11 kundër të pandehurve të përmendur më lart.

Pas vendimit të personit përgjegjës të ekipit të gjyqtarëve të EULEX-it , të lëshuar me 1 nëntor 2011 për të emëruar gjyqtaren e EULEX-it Mariola Pasnik si gjyqtare konfirmuese, seanca për konfirmim të aktakuzës u mbajt para kësaj gjyqtareje.

Të gjitha palët kanë përmbushur obligimet lidhur me zbulimin e dëshmive, siç parashihet me nenet 307 dhe 308 të KPPK-së. Në veçanti, të gjitha deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve/ palëve të dëmtuara iu janë vënë në dispozicion avokatëve mbrojtës.

Prokurori Special e lexoi aktakuzën dhe luti gjykatën që ta konfirmojë atë sepse ka dëshmi të mjaftueshme për të përkrahur dyshimin e bazuar se të dy të pandehurit kanë kryer veprën penale e cila i vihet ne barrë me këtë në aktakuzë.

Gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës të mbajtur me 9 nëntor 2011 të dy të pandehurit Besim Tahiri dhe Nijazi Tahiri ishin në dijeni të plotë për përmbajtjen e aktakuzës dhe u deklaruan të pafajshëm në lidhje me pikën e aktakuzës.

Avokati mbrojtës Masar Morina kundërshtoi kualifikimin ligjor të veprës penale duke theksuar se nuk ka asnjë dëshmi të vetme në shkresat e lëndës që dëshmon se të pandehurit kanë vepruar si grup. Më tutje, avokati mbrojtës Masar Morina deklaroi se të gjitha dëshmitë e përmendura në aktakuzë janë ofruar nga PSRK përpos Urdhrit për masa të fshehta –përgjimi i bisedave telefonike.

Avokati mbrojtës Haxhi Millaku kundërshtoi mënyrën sesi Zyra e Prokurorisë ka kryer hetimin dhe vuri në pikëpyetje deklaratat e palëve të dëmtuara pasi që as avokatët mbrojtës e as të pandehurit nuk kanë pasur mundësi të kundërshtojnë deklaratat e palëve të dëmtuara të dhëna para policisë si dhe para PSRK-së. Gjithashtu , avokati mbrojtës Haxhi Millaku propozoi që të zëvendësohet paraburgimi për të pandehurin Besim Tahirin me masat alternative-Dorëzani për t'u kombinuar me premtimin e të pandehurit për të mos ndërruar vendbanimin e tij.

Prokurori i PSRK-së theksoi se aktakuza nuk është e bazuar në dëshmitë e mbledhura nëpërmjet përgjimit të bisedave telefonike kështu që nuk ka nevojë për komente të më tutjeshme.

Kështu që, në lidhje me arsyet e përmendura më lart , gjykata konstaton se të gjitha dëshmitë në shkresat e lëndës janë të pranueshme.

Aktakuza plotëson të gjitha kërkesat e nenit 305, Paragrafi 1, i KPPK-së.

2. Dyshimi i bazuar i fajësisë për pikën e aktakuzës

Kjo gjyqtare konsideron se ekziston dyshim i bazuar se të pandehurit Besim Tahiri dhe Nijazi Tahiri kanë kryer veprën penale në ljalë, siç iu vihet në barrë në aktakuzë, dhe nuk janë të pranishme të gjitha rrethanat tjera të listuara në nenin 316 paragrafët 1 deri në 3 të KPPK-së, të cilat kanë mundur të motivojnë hedhjen e aktakuzës,

Në lidhje me kërkesën e avokatit mbrojtës Haxhi Millaku për zëvendësimin e paraburgimit me masa alternative , gjyqtarja konfirmues sipas nenit 275, par. 2 dhe 286, par. 2 i KPPK-së, do të dorëzojë shkresat e lëndës dhe kërkesën kryetarit të trupit gjykues për ta marrur në shqyrtim pasi që aktakuza të bëhet e formës së prerë.

Në përfundim, të gjitha dëshmitë e përmendura më lart dhe konstatimet përkrahin një dyshim të bazuar mirë se të dyshuarit e përmendur më lart kanë kryer veprën penale siç iu vihet në barrë me këtë aktakuzë.

Kualifikimi ligjor i cili u sugjerua nga Prokurori Publik në aktakuzë është gjithashtu në rregull, pasi qe vepra penale e përshkruar në mënyrë të drejtë bie nën përcaktimin ligjor dhe dispozitat e KPPK-së siç referohet në aktakuzë.

Duke u bazuar në arsyetimin më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT
Me 9 nëntor 2011



Gjyqtari konfirmues

Mariola Pasnik

Mjeti juridik:

Në pajtim me nenin 432 dhe nenin 434 (2) të KPK-së ky aktvendim mundet të ankimohet brenda tri (3) ditëve nga dita dhe koha e dorëzimit tek kolegji prej tre gjyqtarëve i kësaj gjykate nga palët dhe personat drejtat e të cilëve janë shkelur .